



















### Legjendë:

-  shportë në të cilën rradhiten mollët
-  katror 1
-  katror 2
-  pre
-  mos pre

Mollë me numra për në shirit



Mollë për në shportë





**1**

**2**

**3**

**4**

**5**

**6**

**7**


**8**

**9**

**10**

# #INNO4EDU

<b>Emri i aktivitet</b>	
Matematikë frutore	
<b>Mosha</b>	
6-8 vjeç	
<b>Vendi / lokacioni</b>	<b>Vlerë karakteri</b>
Hapësirë e brendshme ose e jashtme	Љубопитност, самодоверба, истрајност
<b>Koha e nevojshme për përgatitje</b>	<b>Koha e nevojshme për realizim</b>
20 minuta	25-30 minuta
<b>Qëllimet</b>	
Qëllimi është që fëmija të dijë të zgjedh dhe të përdor strategji përkatëse për përllogaritje dhe zgjidhje të problemeve matematikore.	
<b>Rezultate të pritshme</b>	
Fëmija përzgjedh dhe përdor strategji përkatëse për përllogaritje dhe zgjidhje të problemeve matematikore.	
<b>Kahje</b>	
<b><u>Përgatitje paraprake për aktivitet (në Qendrat për mësim)</u></b>	
Prerje e materialeve nga shtojcat, dru me legjendë, mollë dhe shirit me numra, 2 gota	
<b><u>Instrukcione / kahje për lojën</u></b>	
Shpjegim i rregullave të lojës në të cilën mund të marrin pjesë edhe anëtarë tjerë të familjes.	
<b><u>Aktivitet / lojë</u></b>	
Fëmija tërheq nga një fletëz me numër nga gota e parë dhe e vë në katrorin e sipërm të trungut e pastaj vendos po aq mollë në gjysmën e majtë të shportës. Pastaj tërheq numër nga gota e dytë dhe e vë në katrorin e poshtëm të trungut dhe vendos po aq mollë në gjysmën e djathtë të shportës. Numrat e trungut mbledhen dhe rezultati zbulohet përmes lëvizjes së shiritit me mollë, në të cilin janë shkruar numra, ndërkaj saktësia e rezultatit kontrollohet përmes numërimit të mollëve në shportë.	



Shtojca	Materiale
<p><u>Shtojca nr. 1</u> _Hap pas hapi – rregulla të lojës</p> <p><u>Shtojca nr. 2</u> Dru në format A3</p> <p><u>Shtojca nr. 3</u> Mollë me numra</p> <p><u>Shtojca nr. 4</u> Mollë për në shportë</p> <p><u>Shtojca nr. 5</u> Shirit me mollë me numra</p> <p><u>Shtojca nr. 6</u> Numra nga 1 deri në 10</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gërshërë;</li> <li>• 2 gota</li> </ul>
<p><b>Aktiviteti është përgatitur nga:</b></p>	
<p>Edukatorë: Lile Arsova, Zivka Stoilkovska, Mare Angelovska, Sonja Calovska, Vesna Peceva  Dizajnerë grafikë: Vanja Shtrkova, Katerina Nikolovska  Fotografi: Ena Utevska  Lekturë: Jana Mihajlovska – Ivanov  Përkthim: Agim Leka, Jetmir Ziba</p>	



## Shtojca nr. 1 – Udhëzime për realizimin e aktivitetit

Në letra janë shënuar numrat nga 1 deri në 10 (dy herë) dhe ndodhen në dy gota prej të cilave fëmija tërheq (grumbulli i parë dhe i dytë)

Gjatë tërheqjes të parë, numrin të cilin do ta tërheq fëmija duhet ta thotë me zë, ta vendos në degën e katrorit të parë, dhe pastaj të vendosë aq molla në njëren anë të majës të pemës.

Pastaj, fëmija e tërheq numrin e dytë të cilin duhet ta vendos në katrorin e dytë dhe të vendos aq molla në anën tjetër të majës të pemës.

Bëhet llogaritja e shumës. Fëmija duhet të kërkojë rezultatin në shiritin me numra dhe ta lëviz për ta vendosur në vendin e shumës.

Në fund, duhet të numërojë numrin e përgjithshëm të mollave në majë dhe të kontrollojë nëse rezultati është i saktë.

Loja përsëritet deri sa të jetë e nevojshme apo deri sa ka interes dhe dëshirë për të luajtur.

Fjalët me të cilat prindi do ta fillojë lojën mund të jenë të ndryshme për çdo lojë të ardhshme (tregim, tekst të shkurtër, këngë, detyrë tekstuale, dhe të ngajshme)

### **Për shembull:**

„Dje në fshat mora një mollë të bërë. Bëj plane për të bërë reçel dhe i numëroj mollarat shpejtë dhe thjeshtë. Hajde dhe ne të numërojmë molla. Para teje ka gota. Në njëren gotë ka numra prej 1 deri në 10, kurse në tjetren ka molla. Këtu është edhe pema e mollës. Te degët ka dy katrorë dhe shiriti me numra. Nga gota e parë duhet të tërheqësh një numër, ta thuash me zë dhe ta vendosësh në katrorin e parë. Ky është grumbulli juaj i parë. Tani ju duhen aq molla nga gota tjetër te cilat duhet ti vendosësh në njëren anë në majë të degës të pemës. Tani tërhiqni grumbullin e dytë dhe vendosni në katrorin përkatës dhe pastaj numëroni aq molla dhe vendosni në anën e dytë të pemës. Përpiqu që të gesh (llogarisish) rezultatin, për ta gjetur në shiritin me numra dhe ta vendosësh në vendin e vet. Nëse nuk jeni i sigurtë, në fillim numëroni të gjitha mollarat në pemë, apo për të kontrolluar njohuritë tuaja (nëse rezultati është i saktë).“

Fjalë për motivim: Bravo, ashtu vazhdo, përpiqu përsëri, ja arrite, mos u dorëzo, ki kujdes gjatë numërimit

Gjatë lojës, fëmija merr një pikë (apo stiker) për çdo përgjigje të saktë.

Në fund të aktivitetit qerasemi me një copë mollë të shijshme.

Fotografi nga aktiviteti

